**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KËSHILLI BASHKIAK**
**LUSHNJE**

**Nr.** 9355/1 **Prot.** **Lushnje, më** 22/10 **/2025**

**PROJEKT - VENDIM**

**NR.** 98 **Datë** 22/10**/2025**

**"PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR ANGAZHIMIN E BASHKISË LUSHNJE PËR NEUTRALITET KLIMATIK DERI NË VITIN 2050"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës __/__/__ pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit "Për angazhimin e Bashkisë Lushnje për Neutralitet Klimatik deri në vitin 2050", mbështetur në Ligjin nr. 155/2020 "Për Ndryshimet Klimatike", Ligjit nr. 24/2023 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme", në nenet 26, 22 pika 2 dhe neni 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (NECP), dhe në kuadër të pjesëmarrjes së Bashkisë Lushnje në iniciativën "NetZeroCities Twinning Programme",

**PROPOZOJMË:**

1. Bashkia Lushnje angazhohet të ndërmarrë masa konkrete për të arritur neutralitetin klimatik deri në vitin 2050, duke synuar reduktimin gradual të emetimeve të gazeve serrë në përputhje me objektivat e Bashkimit Evropian dhe politikave kombëtare mjedisore.
2. Bashkia do të përgatisë dhe miratojë një Plan Lokal për Klimën dhe Energjinë e Qëndrueshme (SECAP), i cili do të përfshijë:
   - Analizën e burimeve të emetimeve të $CO_2$;
   - Masat afatshkurtra dhe afatgjata për reduktim të ndotjes dhe përmirësim të efikasitetit energjetik;
   - Fushata ndërgjegjësuese dhe përfshirje të komunitetit lokal, institucioneve dhe sektorit privat.
3. Këshilli Bashkiak njeh dhe mbështet përfshirjen e Bashkisë Lushnje në rrjetet evropiane për neutralitet klimatik, përfshirë NetZeroCities Twinning Programme, si një instrument për shkëmbim përvojash dhe zhvillim kapacitetesh lokale.

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit, për zbatimin e këtij vendimi dhe për raportim periodik në Këshillin Bashkiak mbi progresin e planit të veprimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit,**
**Politikave Sociale dhe Informimit**
**Ariola Korreshi**

**Drejtoria Juridike**
**Bedri Hida**

**KRYETARI I BASHKISË**
**Eriselda Sefa**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIALUSHNJE

Nr. 9355 Prot.

Lushnje, më 22 / 10 /2025

# RELACION
# PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK

## "PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR ANGAZHIMIN E BASHKISË LUSHNJE PËR NEUTRALITET KLIMATIK DERI NË VITIN 2050"

Qëllimi i këtij vendimi synon formalizimin e angazhimit të Bashkisë Lushnje për të arritur **neutralitetin klimatik deri në vitin 2050**, në përputhje me objektivat e Bashkimit Evropian dhe politikën kombëtare për energjinë dhe klimën.
Përmes këtij vendimi, Bashkia Lushnje duhet të shpreh publikisht vullnetin për të reduktuar gradualisht emetimet e gazeve serë dhe për të ndërtuar një qytet më të qëndrueshëm, më të gjelbër dhe më rezilient ndaj ndryshimeve klimatike.

Bashkia Lushnje, si një nga qendrat kryesore bujqësore të vendit, përballet me sfida të ndjeshme mjedisore dhe ekonomike që lidhen me:

- ndotjen nga transporti dhe aktiviteteve bujqësore;
- mungesën e efikasitetit energjetik në ndërtesat publike e private;
- nevojën për menaxhim më të qëndrueshëm të mbetjeve dhe burimeve ujore.

Ky vendim është një hap i rëndësishëm për të orientuar politikat lokale drejt një zhvillimi klimatikisht neutral dhe për të mundësuar pjesëmarrjen aktive të Bashkisë në **rrjetet evropiane të bashkive për neutralitet klimatik**, përfshirë **NetZeroCities Twinning Programme**, në të cilin Bashkia Lushnje është tashmë e angazhuar si pjesë e procesit të aplikimit për periudhën 2026.

**Objektivat specifikë të këtij projekti janë:**

- Përgatitja dhe miratimi i një **Plani Lokal për Klimën dhe Energjinë e Qëndrueshme (SECAP)**;
- Zhvillimi i projekteve për reduktimin e emetimeve në transport, energji dhe menaxhim të mbetjeve;
- Fushata ndërgjegjësuese me qytetarët, bizneset dhe fermerët për praktika të gjelbra;
- Bashkëpunim ndërkombëtar për përfitimin e fondeve dhe shkëmbimin e përvojave.

**Në përfundim të këtij prijekti pritet:**

- Përmirësim i cilësisë së ajrit dhe i shëndetit publik;
- Kursime buxhetore përmes efikasitetit energjetik;

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

- Rritje e aksesit në financime evropiane për projekte mjedisore;
- Rritje e reputacionit të Bashkisë si pjesë e qyteteve evropiane të angazhuara për klimën.

Miratimi i këtij vendimi nga Këshilli Bashkiak i jep Bashkisë Lushnje bazën institucionale dhe ligjore për të ndërmarrë politika dhe projekte konkrete drejt **neutralitetit klimatik deri në vitin 2050**, duke ndërtuar një model zhvillimi të qëndrueshëm dhe bashkëkohor në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

**DREJTORIA E PËRGJITHME E INTEGRIMIT, POLITIKAVE SOCIALE DHE INFORMIMIT**

**Ariola Korreshi**

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel: +355 35 222139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com